

# REPUBLIKA E SHQIPËRISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E POLICISE SË SHTETIT

KËSHILLI KOMBËTAR I  
RADIOS DHE TELEYZIONTT

Nr.2014 Prot, datë 06.04.2007

Nr.299 Prot, datë 20.02.2007

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E  
TATIMEVE

ENTI RREGULLATOR I  
TELEKOMUNIKACIONEVE

Nr.1475/2 Prot, datë 23.03.2007

Nr.438/5 Prot, datë 04.04.2007

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Sot, me datë 04.04 .2007, në Tiranë, lidhet kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (Marrëveshja) nga dhe midis palëve:

1. **Këshlli Kombëtar i Radios dhe Televizionit** - organizëm i pavarur, i cili vepron në bazë të Ligjit Nr. 8410 datë 30.09.1998 "Për Radion dhe Televizionin Publik e Privat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i përfaqësuar nga titullari i tij, Kiyetari Z. Ledi Bianku, këtu dhe me poshtë i njohur si **KKRT-ja**;

2. **Enti Rregullator I Telekomunikacioneve** - subjekt juridik, publik, jobuxhetor i cili vepron në sektorin e telekomunikacioneve në bazë të Ligjit Nr.8618, datë 14.6.2000 "Për Telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, me adresë Rr. "Reshit Collaku" Nr.43, Tiranë, i përfaqësuar nga Kryetari i Keshillit Drejtues dhe Drejtor Ekzekutiv, Z. Hydajet Kopani, ketu dhe më poshtë i njohur si **ERT-ja**;

3. **Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit** - organi më i lartë administrativ dhe teknik brënda Policisë së Shtetit, e organizuar dhe që funksionon në bazë të Ligjit Nr. 8553, date 25.11.1999 Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, e përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, këtu dhe më poshtë e quajtur si **DPPSH**;

4. **Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve** - autoriteti qëndror i vetem tatimor në Republikën e Shqipërisë, që vepron në bazë të Ligjit Nr.8560, datë 22.12.1999 Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, e përfaqësuar nga Drejtori i Pergjithshem, Z. Alfred Prifti, ketu dhe më poshtë equajtur si **DPT**.

## Neni 1 Rëndësia

Duke qënë se:

1.1 Veprimtaria Radiotelevizive dhe Telekomunikacionet kanë pësuar një rritje të shpejt dhe të konsiderueshme në treg si në aspektin sasior ashtu edhe në atë cilësor,

1.2 Mosrespektimi i kuadrit ligjor, kushteve të licensave dhe akteve rregullatore në këto fusha përbën një dukuri me përmasa dhe pasoja të përhershme, që kërkojnë zgjidhje të menjehershme dhe të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

1.3 Detyrimet, që rrjedhin nga zbatimi i MSA, përcaktojnë ndërmjet të tjerash, marrjen e masave për përmirësimin e situatës në tregun e transmetimeve radiotelevizive dhe të telekomunikacioneve, me qëllim përfaqshjen me standartet e BE-së.

1.4 Spektri i Radiofrekuencave është një burim natyror i kufizuar, i cili për sigurimin e përdorimit të frytshëm dhe pa interferenca të radiofrekuencave në përputhje me Planin Kombëtar të Radiofrekuencave, administrohet dhe mbikqyret nga ERT (tërë spektri i Radiofrekuencave) dhe KKRT (vetëm për radiofrekuencat që përdoren për transmetimet radio dhe televizive);

1.5 KKRT dhe ERT si institucione përgjegjëse në fushat respektive, po luajnë gjithnjë e më tepër një rol me të dukshëm në drejtim të ushtrimit të kompetencave dhe detyrimeve ligjore, me qëllim imponimin e repektimit të legjislacionit dhe rregulloreve në zbatim të tij;

1.6 DPPSH është organi më i lartë administrativ dhe teknik brënda Policisë së Shtetit, e cila në interpretim të nenit 58 të Ligjit Nr.8553, sipas rastit dhe nevojës bashkëpunon me KKRT-në dhe ERT-në, për garantimin e zbatimit të legjislacionit respektiv të fushës gjatë mos respektimit dhe mbikqyrjes së veprimtarisë së subjekteve, që ofrojnë shërbime në këto fusha, si dhe ekzekutimin e vendimeve ndaj tyre në raste të konsumimit të kundravajtjeve administrative;

1.7 DPT, nëpërmjet strukturave në varësi si Policia Tatimore etj, siguron një zbatim uniform të ligjeve dhe të rregulloreve që kanë të bëjnë me tatimet;

Atëherë:

1.8 Palet, respektivisht në mbështetje të nenit 137/5 të Ligjit Nr.8410 nenit 97 të ligjit Nr.8618, nenit 58 të Ligjit Nr. 8553 dhe nenit 23 të Ligjit Nr.8560. bien dakort për sa më poshtë vijon;

## Neni 2 Objekti

Rregullimi i bashkepunimit midis paleve, me akt normativ te perbashket, me qellim mbeshtetjen e strukturave te KKRT-se dhe ERT-se, gjate ushtrimit te detyrimeve dhe kompetencave ligjore per mbikqyrjen, inspektimin, dhenien e masave administrative dhe ekzekutimin e vendimeve, ndaj subjekteve qe shkelin legjislacionin e fushes, kushtet e licensave dhe rregulloret perkatese.

## Neni 3 Baza ligjore

Kjo marreveshje lidhet dhe zbatohet nga palet ne mbeshtetje te kesaj baze ligjore:

- 3.1 Ligj Nr. 8410, date 30.09. 1998 "Per radion dhe televizionin publik e privat ne Republiken e Shqiperise" (Ligji Nr.8410), i ndryshuar, nenet 137/2 dhe 137/5;
- 3.2 Ligj Nr.8618, date 14.6.2000 "Per Telekomunikacionet ne Republiken e Shqiperise" (Ligji Nr.8618), i ndryshuar, neni 97;
- 3.3 Ligj Nr.8553, date 25.11.1999 "Per Policine e Shtetit" (Ligji 8553), i ndryshuar, neni 58;
- 3.4 Ligj Nr. 8560, date 22.12.1999 "Per Procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, neni 16,17 dhe 23;
- 3.5 Ligj Nr. 9333, date 6.12.2004 "Per disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 8560, date 22.12.1999 "Per Procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise", te ndryshuar". neni 1, 2,3;
- 3.6 Ligj Nr. 7697, date 7.4.1993 "Ter Kundravajtjet Administrative" (Ligji Nr 7697) i ndryshuar;
- 3.7 Ligj Nr. 8485, date 12.5.1999 "Kodi i Procedurave Administrative te Republikes se Shqiperise".

## Neni 4 Fusha e veprimit

Dispozitat e kesaj Marreveshje zbatohen nga palet nenshkruese ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise.

Marreveshja eshte e zbatueshme per DPPSH dhe DPT ne mbeshtetje te strukturave te KKRT-se dhe ERT-se, per sa percaktohet ne kete Marreveshje ne mbeshtetje te legjislacionit referues. Ne kompetence te paleve eshte zbatimi i dispozitave te kesaj marreveshje vetem ne perputhje me kompetencat dhe detyrimet ligjore te percaktuara ne legjislacionin perkates mbi bazen e te cilit vepron dhe ushtron fiinksionet secila nga palet.

## Neni 5

### Bashkepunimi

5.1 Për zbatimin e detyrimeve të përcaktuara në dispozitat ligjore të sipërsëhënuara, palët do të rregullojnë bashkëpunimin midis tyre mbi bazën e kësaj Marrëveshje.

5.2 Inspektoret e KKRT-së dhe/ose ERT-së gjatë bllokimit dhe mbylljes me vulosje të pajisjeve, për përdorimin e të cilave nuk është marrë licencë dhe/ose nuk janë të miratuara apo nuk plotësojnë kushtet e licenses, nëse do të pengohen gjatë kryerjes së detyrës, mbi bazën e kërkesës së tyre do të shoqërohen dhe mbështeten nga ana e forcave të Policisë së Rendit.

5.3 Ekzekutimi i vendimeve të KKRT-së dhe/ose ERT-së lidhur me gjobat dhe pezullimet e afatit të licencave do të kryhet nga ana e forcave të Policisë Tatimore. Veprimet e Policisë Tatimore kryhen në prezencë të inspektoreve të KKRT dhe/ose ERT-së.

5.4 Në rastet kur subjektet nuk paguajnë në mënyrë vullnetare masën e gjobës së vendosur, atëherë në zbatim të Ligjit Nr. 7697, ajo nxirret duke vënë sekuestro mbi pajisjet e tyre në vlerën e gjobës. Sekuestrimi i pajisjeve do të realizohet nga ana e forcave të Policisë Tatimore. Veprimet e Policisë Tatimore kryhen në prezencë të inspektoreve të KKRT dhe/ose ERT-së.

5.5 Kur vlera e gjobës nuk është e mundur të nxirret e plotë vetëm nga pajisjet, sekuestrimi i të cilave nuk sjell ndërprerjen e transmetimit, atëherë sekuestro do të vendoset deri në kufijtë e sigurimit të vlerës së gjobës, edhe mbi ato pajisje, sekuestrimi i të cilave sjell si pasojë ndërprerjen e transmetimit të operatorit Radioteleviziv. Veprimet e Policisë Tatimore kryhen në prezencë të inspektoreve të KKRT dhe/ose ERT-së.

5.6 Mosnderpreja e transmetimit në mënyrë vullnetare nga subjektet, kur KKRT dhe/ose ERT ka marrë vendim për pezullimin e afatit të licencës (bllokimi i transmetimit), atëherë vendimi do të kërkojë të ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga ana e forcave të Policisë Tatimore. Veprimet e Policisë Tatimore kryhen në prezencë të inspektoreve të KKRT dhe/ose ERT-së.

5.7 Vendimet e KKRT-së dhe/ose ERT-së, për heqjen dhe deklarimin e pavlefshmerisë së licencave, ekzekutohen nga Policia Tatimore. Duke qënë se subjektet, në zbatim të akteve ligjore dhe në ligjore për procedurat tatimore për regjistrimin në organet tatimore, duhet të disponojnë licencat respektive që jep KKRT-ja dhe/ose ERT-ja, atëherë organet tatimore me kërkesën me shkrim të KKRT-së dhe /ose ERT-së, ose kryesisht kur kanë dijeni, do të veprojnë në zbatim të Ligjit Nr. 8560 dhe Udhezimeve përkatëse të Ministrisë së Financave, në mbështetje të dispozitave për masat ndaj veprimtarive tregtare të pa pajisura me licencë nga organet kompetente sipas legjislacionit të fushës. Veprimet e Policisë Tatimore kryhen në prezencë të inspektoreve të KKRT dhe/ose ERT-së.

5.8 Për të gjitha detyrat e përcaktuara në pikat "5.3", "5.4", "5.5", "5.6", "5.7", veprimet e Policisë Tatimore kryhen në prezencë të inspektoreve të KKRT sipas vlerësimit të tyre.

5.9 Gjate kryerjes se veprimeve monitoruese, lidhur me perdorimin e spektrit te radiofrekuencave, DPPSH sipas kerkeses paraprake me shkrim te KKRT-se dhe ERT-se, do te bashkepunojte duke krijuar lehtesira per parkimin dhe ruajtjen e Qendres se Levizshme te Monitorimit (Automjetit se bashku me pajisjet) ne objektet qe administrohen dhe disponon ne tere territorin e Republikes se Shqiperise

5.10 Palët angazhohen te bashkepunojne ne çdo rast tjetër të pa përcaktuar specifikisht në këtë marrëveshje por që është i bazuar ne legjislacionin mbështetës referues

5.11 Palët do te emerojne nga nje përfaqesues per ndjekjen dhe realizimin e bashkepunimit qe percakton kjo Marrëveshje.

#### Neni 6 Procedura

Për zbatimin e kësaj Marrëveshje palët do të komunikojnë me njëra – tjetrën për çdo rast me shkrim, në respektim te dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe do të bëjnë përpjekje maksimale per shkembimin e shkresave ne nje afat kohor sa më të shkurtër

#### Neni 7

##### Të tjera

7.1 Kjo Marrëveshje hyn ne fuqi me daten 6 .04 .2007 dhe eshte e vlefshme deri ne shfuqizim e saj me Vendim unanim te paleve nënshkruese.

7.2 Cdo mosmarrëveshje midis paleve per shkak te mos zbatimit te kushteve te përcaktuara ne kete Marrëveshje do te zgjidhet me mirekuptim ose ne rruge administrative ne perputhje me Kodin e Procedurave administrative.

7.3 Kjo Marrëveshje mbahet ne 4 ekzemplare origjinale, nga nje per secilen pale.

7.4 Asnjë ndryshim nuk mund t'i behet Marrëveshjes ne menyre te njehshme nga secila prej paleve nënshkruese, perverse me Vendim te perbashket me shkrim.

DREJTORIA POLICISË  
SË SHTETIT  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**AHMET PREMÇI**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME  
E TATIMEVE  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

**ALFRED PRIFTI**

KËSHILLI KOMBËTARË I  
RADIO DHE TELEVISIONIT  
KRYETAR

**LEDI BIANKU**

ENTI RREGULLATOR  
I TELEKOMUNIKACIONEVE  
KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

**HYDAJET KOPANI**